



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI I LËNDËS
Përdorimi i drejtë i Gjuhës Greke

Ngarkesa mësimore: 6 kredite; 60 orë mësim; 30 leksione / 30 seminare

Viti / Semestri: Viti II/ Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimeve: Master ‘Mësuesi’

Kodi i etikës: Kodi i Etikës së Universitetit të Tiranës (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Të pajisë studentët me njohuri të thelluara mbi problemet gjuhësore që lidhen me historinë dhe drejtshkrimin e gjuhës së re greke. Të përmirësojë kompetencat gjuhësore dhe komunikuese të studentëve përmes përdorimit të saktë të strukturave dhe mjeteve stilistike të gjuhës greke. Të zhvillojë aftësi reflektuese dhe pedagogjike për përdorimin e gjuhës në kontekste mësimore dhe komunikative.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të nxisë studentët të analizojnë dhe të kuptojnë përdorimin e fjalëve dhe shprehjeve që shkaktojnë paqartësi në komunikim, si dhe të identifikojnë dhe korrigjojnë gabimet më të zakonshme.
2. Të zhvillojë aftësinë për të komentuar përdorimin e duhur të gjuhës greke dhe për të ndërtuar një qëndrim të vetëdijshëm mbi zhvillimin e saj historik dhe ndryshimet gjuhësore në kohë.
3. Të pajisë studentët dhe mësuesit me mjete praktike që mund të zbatohen në klasë për arritjen e rezultateve sa më të mira në të mësuarin dhe të mësuarin e gjuhës greke.